

## STATUTI & AKTI I THEMELIMIT

i

### Shoqerise "DeltaRex" shpk

#### Hyrje Baza Ligjore

Në këtë statut

- "Ligi" referues është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare";
- "Ligi" 9723, dt.03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Tregtare"
- "Statuti" është dokumenti i vetëm ligor i shoqërisë, ku përcaktohen ne mënyrë specifike rregullimi i veprimitarës dhe organizimi i shoqërisë.

#### **Neni 1** Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

**1.1 Sot, më 11.11.2019 ( Njemedhjete, Nentor, Dymije e Netemedhjete), une themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin DELTAREX sh.p.k.**

1.2 Themeluesi i shoqërisë janë: Aldi Saracj.

1.3 Shoqeria e emëruar "DELTAREX" shpk (më poshtë e quajtur "Shoqëria"), është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuara, themeluar në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërise

1.4 Shoqëria fiton personalitetin e saj juridik pas regjistrimit të saj në Regjistrin Tregëtar Shqiptar pranë Qëndrës Kombëtare te Tregtare.

1.5 Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin Shqiptar dhe Statutin.

#### **Neni 2** Objekti

**2.1 Objekti i veprimitarës së Shoqërisë do të përfshijë, por nuk do të kufizohet vetëm në Ndërtim dhe Rikonstruksioni objekteve dhe veprave të cfarëdollojëshme industrial, turistike, civile. Sistemime, Asfaltime dhe Ndertime Rrugësh, Mirembajtje Rutine dhe Dimerore te Rrugeve, Sinjalsitike dhe Siguri Rrugore, punime Ujesjellesash dhe bonifikimi, prodhim të materialeve të ndërtimit si dhe transportin e tyre.**

#### **Neni 3** Kohëzgjatja

**3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar nga data e regjistrimit të shoqerise ne Regjistrin Tregtar.**



i

**Neni 4**  
**Selia**

**4.1 Zyra qëndrore e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rr.Elbasanit, Nd.38, H.6, Ap.12,  
Njesia administrative Nr.2, Tirane.**

**4.2 Shoqëria mund të hapë zyra përfaqësimi, degë dhe ose filiale të marrë pjesë në shoqëri  
të tjera, të kryejë aktivitet ne vende të tjera, qoftë brenda vendit apo jashtë teritorit të  
Shqipërisë, në përputhje me vendimet e Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve**

**Neni 5**  
**Kapitali themelt**

**5.1 Kapitali themeltar filletar i Shoqërisë është 100,000 Lekë I ndare ne 1 kuote me  
vlerë nominale prej 100,000 Lekë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë  
është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:**

- 1. Ortaku themelus**
- 2. Z. Aldi Saraçi, i datëlindjes 06.10.1985, lindur ne Shkoder, me Karte Identiteti  
Nr. 029409538 dhe Nr.personal I51006078U: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlerë  
të përgjithshme 100,000 Lekë që përbëjnë 100% të kapitalit themeltar të  
shoqërisë.**

**5.2 Kuotat janë të transferueshme dhe mund të transferohen në cdo kohë në  
përputhje me kushtet dhe afatet që përcaktohen në ligjin Shqiptar. Përgjegjësia e  
Ortakut shtrihet deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin e Shoqërisë.**

**Neni 6:**  
**Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit**

**6.1 Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të  
kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë,  
nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto  
kontribute sipas kërkesës së administratorit.**

**6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij  
në kapitalin themeltar të shoqërisë.**

**6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të  
njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i  
prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.**

**Neni 7**  
**Transferimi i kapitalit**

**7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që  
rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:**

- 7.1.1 kontributit në kapitalin e shoqërisë;**
- 7.1.2 shitblerjes;**
- 7.1.3 trashëgimisë;**
- 7.1.4 dhurimit;**
- 7.1.5 çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.**

**7.2** Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

**7.3** Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **Neni 8 Organi Vendimmarres**

**8.1** Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

**8.2** Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

**8.3** Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjejëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

8.3.1 përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

8.3.2 ndryshimet e statutit;

8.3.3 emërimin e shkarkimin e administratorëve;

8.3.4 emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar;

8.3.5 përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në pikën "8.3.3" dhe "8.3.4" të kësaj pike;

8.3.6 mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

8.3.7 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

8.3.8 zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

8.3.9 pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

8.3.10 përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

8.3.11 riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

8.3.12 miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

8.3.13 çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**8.4** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

**8.5** Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

**8.6** Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **Neni 9 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

**9.1** Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

**9.2** Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpresa datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

**9.3** Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 9.1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime pavarësisht parregullsisë.



**Neni 10**  
**Kuorumi**

**10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

**10.2** Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

**10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

**Neni 11**  
**Marrja e vendimeve**

**11.1** Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

**11.2** Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

**11.2.1** përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

**11.2.2** emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

**11.2.3** emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

**11.2.4** përcaktimin e shpërblimeve

**11.2.5** mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët,

    përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

**11.2.6** përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

**11.2.7** miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

**11.3** Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**Neni 12**  
**Përashtimi nga e drejta e votës**

**12.1** Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

**12.1.1** vlerësimin e veprimtarisë së tij;

**12.1.2** shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;

**12.1.3** ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;

**12.1.4** dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

**12.2**.Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesë, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**Neni 13**  
**Administrimi**

**13.1** Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

**13.2** Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

**13.3** Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Z. Aldi Saraci, i datëlindjes 06.10.1985, lindur ne Shkoder, me me Karte Identiteti Nr. 029409538 dhe Nr.personal I51006078U, dhe banues ne Shkoder.



(emer/mbiemer, firme)

**Neni 14**  
**Kompetencat e Administratorëve**

**14.1** Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

**14.1.1** kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

**14.1.2** përfaqësojnë shoqërinë tregtare;

**14.1.3** kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

**14.1.4** përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

**14.1.5** krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

**14.1.6** kryejnë regjistimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

**14.1.7** raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

**14.1.8** kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

**14.2** Administratoret janë te detyruar te therasin Asamblene e Pergjitheshme, në rastet kur:

**14.2.1** sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brënda 3 muajve në vazhdim.

**14.2.2** shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

**14.2.3** shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

**14.3** Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

**14.4** Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

**14.5** Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 15 Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, per veprime ose mosveprime të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **Neni 16**

##### **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Tregtare dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

#### **Neni 17**

##### **Ekspertet**

**17.1** Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrolllet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

**17.2** Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar percatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrolllet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

#### **Neni 18**

##### **Prishja dhe likuidimi**

**18.1** Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

**18.1.1** kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;

**18.1.2** me vendim të Asamblese se Ortakeve;

**18.1.3** me hapjen e procedurave të falimentit

**18.1.4** nëse nuk ka kryer veprimtarri tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Tregtare";

**18.1.5** me vendim të gjykatës;

**18.2** Ne kete rast Ortaket marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".  


**18.3** Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**

**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**Neni 21**

**Mosmarrëveshjet**

Per mosmarrëveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarrëveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**Neni 22**

**Ndryshimet**

Ky statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe / ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendesohet me një statut te ri me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Ky statut i shoqerise me perjegjesi te kufizuar "DELTAREX" shpk, hartohet ne 2 kopje ne gjuhen Shqipe me vlore te njejtë secila.

**ORTAKET**

ALDI SARAÇI

